

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Upgrade i Infrastrukturës së IT me Fokus në Performancën e Procesimit, Zgjerimin e Memories dhe Cyber Recovery”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT - *upgrade rrjeti*

VLERA E FONDIT LIMIT: - **119,893,333 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)** lekë, pa TVSH, ose 1,226,279.3 (një milion e dyqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë tre) euro pa TVSH. *Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.08.2025, 1 euro = 97.77 All.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsytimit të mëposhtem:

Ne zbatim të Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 të LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme, sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike, duke bere te mundur vetem Upgrade, zgjerim dhe permiresim te sistemit aktual. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën **jo më pak se vlera e fondit limit**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymen e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 35 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE

ofertues do jete realisht ne gjendje te realizoje kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- 3) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

-Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese.

-Certifikimi **ISO 27001:2022** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendesi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm dhe i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të kryesojë vijimi i mirëmbajtjes dhe upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

-Certifikimi **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.3 Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen e të gjitha produkteve objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota me objekt dhe numer reference të procedurës dhe detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar..

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve/licensimeve specifike që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve/shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve me të larta nga prodhues me famë të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikën e tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet perkatese për furnizimin e produkteve/shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët perkates si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qenë se një pjesë me dërmuese e prokurimit është vazhdimësi për sisteme ekzistuese që janë funksionale dhe tepër të rëndësishme. Operatorët Ekonomikë duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar perkates me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të drejta për të rishitur këto produkte/licensa/shërbime, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pikë 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar për të paktën muajin e fundit dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a. Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhim Projektesh PMP ose ekuivalente;
- b. Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per menaxhimin e sherbimeve ITIL ose ekuivalente;
- c. Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel teknik profesional ose ekuivalente nga prodhuesi per storage per te instaluar dhe implementuar storage te ofertuar.
- d. Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel teknik profesional ose ekuivalente nga prodhuesi per rrjetin per te instaluar dhe implementuar pajisjet e rrjetit te ofertuara.
- e. Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel teknik profesional ose ekuivalente nga prodhuesi per sigurine e rrjetit per te instaluar dhe implementuar pajisjet e sigurise se rrjetit te ofertuara.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar.

Një punonjës mund të disponojë një ose më shumë se një certifikim.

Për të vërtetuar disponimin e stafit te mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm.*
- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, per muajin e fundit (duke marre si reference data e hapjes se ofertave).*

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Qellimi dhe objektivi final i ketyre kriterëve është mosnderprerja e shërbimeve shume te rendesishme te ofruara perdite nga punonjesit dhe sistemet teknologjike te Oshee Group sha, sigurimi i vijimësise se punës, mos rrezikimi i ekspozimit te te dhenave konfidenciale qe permbajne/grumbullojne e menaxhojne keto sisteme dhe sigurisht minimizimi maksimal i humbjeve te palloqaritshme financiare zinxhir qe do shkaktoheshin ne rast nderprerjeje te proceseve te përditshme te punës si rezultat i mos-kryerjes se ketij prokurimi, ne kuader te progresit te vazhdueshem e te pandalshem teknologjik faktik te platformave ekzistuese dhe atyre qe do vijne ne te ardhmen e afert per Oshee Group sha.

Argumentim per kriterin ne piken a):

Te pakten 1 (nje) Menaxher Projekti, kerkohet per te garantuar organizimin e njerëzve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit;

Argumentim per kriterin ne piken b):

Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per menaxhimin e sherbimeve ITIL ose ekuivalente, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, kete specialist duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet multinacionale jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Argumentim per kriterin ne piken c):

duke qene se pjese e prokurimit eshte upgrade dhe suport per zgjidhjet ekzistuese te arkivimit “PowerStore 1200T”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel teknik profesional ose ekuivalente nga prodhuesi per storage per te instaluar dhe implementuar storage te ofertuar për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila eshte me koheshtrirje vjetore

Argumentim per kriterin ne piken d):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel teknik profesional ose ekuivalente nga prodhuesi per rrjetin per te instaluar dhe implementuar pajisjet e rrjetit te ofertuara, për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar “Routing and Switching”, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese në, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Argumentim per kriterin ne piken e):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin

e tij, të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar në nivel teknik profesional ose ekuivalente nga prodhuesi për sigurinë e rrjetit për të instaluar dhe implementuar pajisjet e sigurisë së rrjetit të ofertuara, për këtë lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar për sigurinë e rrjetit “Security Routing and Switching”, duke garantuar AK për mos ndërprerje të shërbimit dhe vijimit të punës. Bejme sqarimin se certifikimet janë teper të specializuara dhe të dedikuara, ndaj duhet të jenë të njëjta certifikimet e kërkuara nga AK. Kjo shërben për të terhequr vëmendjen e operatorëve ekonomik që të jete teper të specializuar në certifikimet që do paraqesin bashkë me ofertën. Specialistet kerkohen për të implementuar, suportuar si dhe për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila është relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e References dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posacem nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

SHENIM: në respektim të nenit 36 të LPP sqarojme se kudo ku përdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbime të ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.